

**09.07.2024
Ora 15:30**

RENDI I DITËS

Projektvendim: Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave, përmes platformës online të vëzhguesve

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z. Ilirjan Celibashi

2. Stafi KQZ: Ermina Alushaj, Madalena Koja

Z. I. Celibashi: Atëherë në seancën e sotme publike në kuadër të përgatitjeve për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 04 Gusht 2024 por jo vetëm në fakt prej projektakteve kemi dy çështje në rendin e ditës “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave, përmes platformës online të vëzhguesve” dhe Projektvendimin “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”.

Znj.E.Alushaj: Faleminderit Komisioner!

Referuar nenit 19, paragrafi 1 shkronja n të ligjit 119 të datës 29.12.2008 Kodi Zgjedhje i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i paraqesim për shqyrtim dhe miratim projektvendimin për procedurat e

**Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.07.2024*

akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave, përmes platformës online të vëzhguesve. Ky projektvendim vjen në pëprthje me parashikimit të ligjit e Kodit Zgjedhor dhe në reflektim të plotë të rolit dhe rëndësisë së vëzhguesëve zgjedhor në çdo fazë të procesit zgjedhor. Vendimi përcakton se kërkesat e organizatave jofitimprurëse shqiptare të huaja përfaqësuesve të shteteve të huaja dhe medias së bashku me dokumentacionin përkatës regjistruhen në KQZ përmes platformës elektronike ku merret dhe akreditimi i tyre. Për sa më lart projektakti për miratimin tuaj. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Ne e kemi konsultuar këtë projektakt dhe partitëq politike organizata të shoqërisë civile. Dakord jam me përmbajtjen ndoshta për titullin e projektaktit dhe në vijë të aktit dhe duhet të ndryshojmë sepse në fakt nuk bëhet ndonjë ndryshim për procedurat e vëzhgimit. Në fakt ky akt thjesht dhe vetëm krijon një opurnitet tjetër shtesë për organizatat e shoqërisë civile ose për vëzhguesit jo politik për tu regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve tanimë edhe ndërmjet platformës elektronike. Kështu që mendoj se tituli më i gjetur i këtij do të ishte: Mbi regjistrimin e vëzhguesve e listës së tyre vëzhguesve, pra Organizata Qeveritare Shqiptare e të huaja, Organizata Ndërkombëtare mund të jetë e njëjta gjë e përfaqësuesve të shteteve të huaja ndërmjet platformës elektronike të regjistrimit të vëzhguesve. Pak a shumë kjo është se nuk është se miratojmë procedura.

Vendim.Nr 72

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



09.07.2024
Ora 15:38

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”.

PJESËMARRJA :

● **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z. Ilirjan Celibashi

2. Stafi KQZ: Ermina Alushaj, Madalena Koja

Z. I. Celibashi: Kemi në rend të ditës projektvendimin “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”.

Znj.E.Alushaj: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja g dhe nenit 2 të Ligjit të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë është hartuar programi i edukimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, i cili është një plan që përcakton qëllimet dhe objektivat kryesore që duhet të realizohen për edukimin informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve në këtë bashki. Ky program përmban 6 objektiva dhe për sa më sipër projektaktin për miratimin tuaj, është konsultuar gjithashtu me të gjitha palët e interesit.

Z.I.Celibashi: Faleminderit atëherë miratojmë programin e edukimit dhe informimit dhe të ndërgjegjësimit të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e

**Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.07.2024*

Bashkisë Himarë të datës 04 Gusht 2024.Çështje të tjera në rend dite nuk kemi? Jo.
Faleminderit ditë të mbarë në vazhdim.

Vendim Nr.71

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*

